

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.97/2023, “PËR BUXHETIN E VITIT 2024”, TË NDRYSHUAR”

A. MËNYRA E NDËRHJRJES

Ky akt normativ propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijnë¹:

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
2. Përkohshmëria e masave, që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
3. Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
4. Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

1. Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit:

Neni 101 ka parashikuar “**nevojën**” dhe “**urgjencën**” si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave, pas vlerësimit 11-mujor dhe pritshmërive në nivel vjetor të treguesve fiskalë, ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të fundit të buxhetit 2024.

Ky rishikim i përgjigjet situatës aktuale në mbështetje të disa shtresave sociale më vulnerabël, nëpërmjet:

- ✓ krijimit të një llogarie speciale në Bankën e Shqipërisë për mbështetjen e pensionistëve, në të cilën po transferojmë rreth 6.3 miliardë lekë;
- ✓ shpërndarjes së një pakete të re të fundvitit për shtresat sociale më vulnerabël, në formën e shpërblimeve të menjëhershme me një kosto rreth 2.2 miliardë lekë.

¹ Vendimi nr.24, datë 10.11.2006, i Gjykatës Kushtetuese.

Njëkohësisht, nëpërmjet këtij akti normativ, reflektohen edhe disa rishikime mes zërave buxhetorë, që synojnë përmirësimin e parametrave të ekzekutimit të buxhetit të vitit 2024, me fokus garantimin e finalizimit në terma optimalë të vitit buxhetor për sa i takon performancës së shpenzimeve, të ardhurave dhe qëndrueshmërisë së parametrave makroekonomikë në tërësi.

2. Përkohshmëria

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45-ditore. Përkohshmëria e këtij akti lidhet me kushtin e domosdoshëm të shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit, akti normativ me fuqinë e ligjit dërgohet për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

B. QËLLIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTI NORMATIV

Ky rishikim i buxhetit 2024, i cili propozohet t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, parashikon:

- ✓ *mbajtjen të pandryshuar të të ardhurave buxhetore në nivel total, duke reflektuar vetëm disa axhustime mes nënzërave të tyre;*
- ✓ *rishpërndarjen e rreth 50 miliardë lekëve mes zërave të shpenzimeve buxhetore, korente e kapitale, me synimin e realizimit sa më të plotë të shpenzimeve publike për vitin 2024;*
- ✓ *rrjedhimisht, ruajtjen të pandryshuar të deficitit buxhetor për vitin 2024, në nivelin e parashikuar prej 57.28 mld lekësh.*

C. ARGUMENTIMI I HARTIMIT TË KËTIJ PROJEKTAKTI NORMATIV

NË KAHUN E TË ARDHURAVE:

Të ardhurat e përgjithshme ruajnë të pandryshuar nivelin total të planifikuar të tyre, por duke reflektuar, si më poshtë vijon:

- ✓ Të ardhurat e njërive të vetëqeverisjes vendore rriten me +2.2 miliardë lekë (*efekt neutral në deficit*), bazuar në performancën pozitive përgjatë periudhës janar-nëntor, duke tejkaluar edhe përditësimin e planit vjetor të tyre në gusht 2024. Plani vjetor i rishikuar i të ardhurave tatimore të pushtetit vendor prej 37.1 miliardë lekësh rezulton me tejkalim bazuar në realizimin faktik të deritanishëm, duke mbështetur për rrjedhojë:

- rritjen e planit të “taksave lokale” me rreth 1.7 miliardë lekë;
 - rritjen e planit të “taksës mbi pasurinë” me rreth 0.5 miliardë lekë.
- ✓ Të ardhurat jotatimore rriten me +1 miliardë lekë, gjithashtu bazuar në ecurinë e kënaqshme të realizimit faktik të deritanishëm dhe pritshmërisë pozitive për mbylljen në këto terma të vitit buxhetor.
 - ✓ Të ardhurat nga grantet e huaja për projekte investimesh ulen me -3.2 miliardë lekë, bazuar në ecurinë e deritanishme dhe vlerësimin e pritshmërive deri në mbyllje të vitit.

NË KAHUN E SHPENZIMEVE:

Shpenzimet e përgjithshme nuk pësojnë ndryshime të nivelit total të planifikuar të tyre, duke reflektuar vetëm rialokime mes zërave me efekt neutral, të cilat konsistojnë në këto drejtime kryesore:

- ✓ **Mbështetjen financiare të disa kategorive** më vulnerabël në masën 15.000 lekë për rreth 144.000 përfitues të kategorive sociale në ndihmë ekonomike dhe aftësi të kufizuar, me një efekt financiar prej **2.2 miliardë lekësh** dhe akomodimin e fondit të sigurimeve shoqërore me rreth **3 miliardë lekë**.
- ✓ **Krijimin e llogarisë së fondit të pensioneve** në Bankën e Shqipërisë, në të cilën transferohen përmes këtij akti normativ rreth **6.3 miliardë lekë**, me qëllim sigurimin e implementimit të politikës së mbështetjes së pensioneve për vitin 2025.
- ✓ **Shtesën e fondeve në masën 1.6 mld lekë për Ministrinë e Brendshme**, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të Policisë së Shtetit për kompensimin ushqimor, orë jashtë orarit/dieta/karburant në kuadër të sezonit intensiv turistik, krahas shlyerjes së detyrimeve nga vendimet gjyqësore të IKMT-së, bazuar në kërkesën nr.12653/1, datë 21.11.2024, të Ministrisë së Brendshme.
- ✓ **Financimin shtesë për skemën e fermerëve** në masën **1.4 mld lekë**, bazuar në kërkesën nr.7659/2, datë 4.12.2024, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim mbulimin e të gjitha kërkesave të aplikantëve, që plotësojnë kriteret e përfitimit për masat mbështetëse për vitin 2024.
- ✓ **Shtesën e fondeve për AKSHI-n** në masën **2.6 mld lekë**, me qëllim shlyerjen e detyrimeve në kuadër të kontratave për mirëmbajtjen e sistemeve IT të

qeverisë dhe pagesës së shërbimit nga *Microsoft*-i, bazuar në kërkesën nr.6236, datë 2.12.2024, të AKSHI-t.

- ✓ **Shtesën e fondeve në masën 1.1 mld lekë për Ministrinë e Mbrojtjes**, me qëllim mbulimin e detyrimeve financiare ndaj NATO-s dhe misioneve ushtarake jashtë vendit, bazuar në kërkesën nr.6823, datë 27.11.2024, të Ministrisë së Mbrojtjes.
- ✓ **Shtesën e fondeve në masën 1.3 mld lekë për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë**, për financimin e detyrimeve të kontratave të mirëmbajtjes rrugore, krahas vendimeve gjyqësore të shpronësimeve.
- ✓ **Financimin shtesë prej 300 mln lekësh**, përkatësisht:
 - *Në masën 100 mln lekë*, bazuar në kërkesën nr.4792/7, datë 25.11.2024, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe shkresën nr.4338/2, datë 13.12.2024, të Kryeministrisë, me qëllim organizimin e tri tureve të para të “Giro d’Italia” në Republikën e Shqipërisë;
 - *Në masën 200 mln lekë*, bazuar në kërkesën nr.7906/1, datë 19.12.2024, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, me qëllim vijimin e financimit të projektit të KOKSH-it “Ekipet sportive në shkolla” dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve.
- ✓ Akomodimin e pjesës së mbetur në masën rreth **520 mln lekë** në zërin “Kontingjencë”, me qëllim **pagesën e diferencës së pagës së magjistratëve**, në zbatim të vendimit nr.35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese.
- ✓ **Akordimin e një fondi në masën 2 mld lekë për shoqërinë “Alb Control”, sh.a.**, si huadhënie në formën e transfertës përmes Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, bazuar në shkresat zyrtare nr.9764/1, datë 16.12.2024, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe nr.15710/1, datë 16.12.2024, të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për këtë qëllim.
- ✓ **Financimin shtesë në masën rreth 1.57 mld lekë për dy projektet e Agjencisë Kombëtare të Kadastrës**, të alokuar në buxhetin e Ministrisë së Financave, bazuar në kërkesën nr.17217/2, datë 16.12.2024, të Ministrisë së Financave, me qëllim financimin për projektet “Digjitalizimi i të dhënave kadastrale të pasurive të paluajtshme” dhe “Regjistrimi fillestar i zonave kadastrale”.

- ✓ **Për sa u takon specifikisht shpenzimeve kapitale**, ato propozohet të rishikohen në ulje me rreth 18.3 miliardë lekë në total, ku projektet *me financim të brendshëm* pakësohen me rreth 7.1 miliardë lekë kryesisht në projekte, të cilat kanë pasur ecuri të ngadaltë dhe kanë kryer me vonesë procedurat e prokurimit. Ndërkohë që shpenzimet kapitale *me financim të huaj kredi* reduktohen me 8 miliardë lekë, në reflektim të ecurisë së ngadaltë të punimeve në disa projekte, kryesisht në sektorin e mbrojtjes, ndërsa projektet me financim të huaj në formën e granteve paraqesin një kursim prej rreth 3.2 miliardë lekësh si rrjedhojë e mosrealizimit kryesisht në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural. Në terma të akomodimeve shtesë, ato konsistojnë kryesisht në:
 - *financimin shtesë (neto) për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në masën rreth 3.6 miliardë lekë, me qëllim përballimin e nevojave për projektet me financim të brendshëm, të cilat kanë pasur ecuri të mirë fizike gjatë vitit 2024, kryesisht projektet e Unazës së Madhe të Tiranës, lotet e rrugës Elbasan - Qafëthanë etj.;*
 - *financimin shtesë në masën 240 mln lekë, bazuar në kërkesën nr.17774, datë 2.12.2024, të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me qëllim blerjen e godinës së Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bruksel.*

- ✓ **Së fundi, në këtë akt normativ propozohet edhe rritja me rreth 1.6 mld lekë e transfertës buxhetore të pushtetit vendor**, me qëllim:
 - për të mbështetur bashkitë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve; buxheti vendor 2024 shtohet me **1.43 miliardë lekë si transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme**, niveli i së cilës rritet në 1.1% të PBB-së (*nga 1% e PBB-së, që është detyrim ligjor sipas ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar*). Kjo transfertë shton edhe 7.7% më shumë fonde për çdo bashki (*përveç Bashkisë Tiranë*) mbi transfertën e pakushtëzuar 2024 të miratuar me ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”.
 - *Për shpërndarjen e kësaj transferte të pakushtëzuar të përgjithshme ndërmjet bashkive është përdorur formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme për vitin 2024. Kriteret e kësaj formule janë të përshkruara në aneksin nr.1 “Transferta e pakushtëzuar, formula e ndarjes së fondeve, kriteret dhe koeficientët e vitit 2024”, të ligjit nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”.*
 - *Kjo transfertë, në radhë të parë, përdoret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, duke i dhënë përparësi detyrimit më të vjetër të papaguar dhe, pasi të jenë shlyer detyrimet, përdoret edhe për shpenzime të tjera. Kjo transfertë nuk përdoret për detyrimet që rrjedhin nga procesi i rindërtimit.*

- Në këtë mbështetje buxhetore **nuk është përfshirë Bashkia Tiranë**, për arsye se kjo bashki ka potenciale të mëdha fiskale për të gjeneruar të ardhura nga taksat e tarifrat vendore. Të ardhurat e Bashkisë Tiranë në tri vitet e fundit zënë mesatarisht rreth 57% të totalit të të ardhurave të 61 bashkive të vendit.
- Njëkohësisht, **në buxhetin vendor 2024 shtohen 173.4 mln lekë si transfertë e pakushtëzuar sektoriale**, për të mbështetur disa bashki në financimin për rivitalizimin e tregjeve tradicionale. Qëllimi është garantimi i tregtimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, rritja e fuqisë negociuese në çmim për fermerin, promovimi i produkteve bujqësore dhe turistike të zonës, me objektiv nxitjen e fermerëve për rritjen e prodhimit bujqësor në sasi e cilësi dhe ofrimin e tyre te konsumatori në kushte optimale.

Kjo, e kombinuar me logjistikë turistike, lidhet jo vetëm me konsumatorin vendas, por edhe me turistët, të cilët kanë mundësinë të blejnë dhe të konsumojnë prodhime lokale të zonave që vizitojnë. Konkretisht financohen tregjet në:

- *Bashkia Vlorë, me vendndodhje në qytetin e Vlorës; Bashkia Durrës, me vendndodhje në Manëz; Bashkia Pukë, me vendndodhje në qytetin e Pukës; Bashkia Divjakë, me vendndodhje në Çermë; Bashkia Gjirokastrë, me vendndodhje në qytetin e Gjirokastrës; dhe Bashkia Shkodër, me vendndodhje në qytetin e Shkodrës.*

NË ASPEKTIN E DEFICITIT DHE TË BORXHIT PUBLIK:

- ✓ **Deficiti buxhetor**, si rrjedhojë e ndryshimeve të mësipërme në të ardhura dhe shpenzime, mbetet i njëjtë sipas atij të miratuar me anë të aktit normativ nr.3, datë 28.8.2024.
- ✓ **Borxhi publik** për buxhetin 2024 rishikohet duke reflektuar ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - *Zëri i huave të huaja afatgjatë ulet me 8.34 mld lekë, duke reflektuar ndryshimet e propozuara në këtë akt normativ për sa u takon projekteve me financim të huaj kredi;*
 - *Në shpenzimet e parashikuara për interesat e borxhit, gjatë vitit 2024 vlerësohet me një kursim në vlerën prej 4 miliardë lekësh, kryesisht si rezultat i efektit të kursit të këmbimit.*

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, theksojmë se ndryshimet e propozuara në këtë akt normativ do të vijojnë të garantojnë trajektoren rënëse të nivelit të borxhit publik në raport me PBB-në, në përputhje me rregullin respektiv fiskal të

përcaktuar në ligjin organik të buxhetit, duke siguruar kështu vijueshmëri dhe konsolidim fiskal dhe të qëndrueshmërisë afatmesme e afatgjatë të financave publike dhe stabilitetin makroekonomik në tërësi.

KËSHILLI I MINISTRAVE